

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Njësia Org. Org. Iedhice Org. Unit	M-01	Nr. Prot: Braj Prot: Prot. No.:	5845/15
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	02	Data: Datum: Date:	19.11.2015
Prichtinë / a			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

*Kabineti i Ministrimit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister*

Nr : 56 / ..... / .....

Data: 19 / 11 / 2015

Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 145, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 Tetor 2010), nenit 8, (paragrafi 1.4.) të Rregullores Nr.02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr.07/2011, si dhe nenit 31 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, (GZK Nr.50/2009),

Nxjerrë:

### V E N D I M

- I. Të përcaktohen kriteret dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procesin e Lejes Mjedisore.
- II. Angazhimet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për shqyrtimin e aplikacionit dhe shërbimet tjera administrative lidhur me procesin e Lejes Mjedisore, vlerësohen si tarifë shërbimi, e cila paguhet nga aplikuesi.
- III. Tarifa e paguar është e pakthyeshme, pavarësisht nëse kërkesa për Leje Mjedisore miratohet ose refuzohet, me vendim përfundimtarë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- IV. Tarifa duhet të jetë e paguar në momentin e dorëzimit të kërkesës me dokumentacionin përcjellës.
- V. Tarifa e shërbimeve paguhet nga aplikuesi në bankë, në adresën: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (llogaria bankare e MMPH), përshkrimi; Tarifë për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore

VI. Vlera e tarifës për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore caktohet në bazë të vlerës financiare të investimit, e dëshmuar nga aplikuesi.

VII. Në tabelë është e paraqitur lartësia e Tarifës

Nr.	Vlera financiare e investimit, në €	Tarifat, në €
1	Deri 200,000.00 (dyqind mijë)	300.00
2	Me e larte se 200,000.00 – 500,000.00 (dyqind mijë- pesëqind mijë)	1000.00
3	Me e larte se 500,000.00 – 1,000,000.00 (pesëqind mijë- një milion)	1500.00
4	Me e larte se 1,000,000.00 – 2,000,000.00 (një milion- dy milion)	2000.00
5	Me e larte se 2,000,000.00 – 3,000,000.00 (dy milion- tre milion)	2500.00
6	Me e larte se 3,000,000.00 (tre milion)	3.000.00

VIII. Vlera e tarifës për shqyrtimin e kërkesë për vazhdimin e Lejes Mjedisore është 150 Euro.

IX. Ky Vendim hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi t'i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministrit*
- *Zyrës Sekretarit të Përgjithshëm*
- *Departamentit të DMM- së*
- *Arkivit të MMPH-së.*

Ferid Agani  
Ministër

